



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 171, datë 03.11.2023



PËR MIRATIMIN PËR HEQJEN NGA KONTABILITETI DHE LISTA PËRFUNDIMTARE, TË PRONËS ME NUMER 374 TË LISTËS SË TRANSFERIMIT, ME EMËRTIM “VENDSTREHIM”, ME VENDODHJE PRANË SHKOLLËS 9-VJEÇARE “EFTALI KOÇI”, QË ME VKM NR. 536, DATË 01.05.2008, KA KALUAR NË PRONËSI TË BASHKISË DURRËS

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, VKM-së nr. 536, datë 01.05.2008, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të Bashkisë Durrës”, i ndryshuar, VKM-së nr.280, datë 15.01.1996, “Për ruajtjen, mirëmbajtjen dhe dhënien me qira të objekteve fortifikuese e mbrojtëse”, i ndryshuar, Ligjit nr. 10296/2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, Ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”, Shkresës nr. 160 prot., datë 07.4.2023, ardhur nga Shoqëria Albakonstruksion shpk, drejtuar Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, me lëndë: “Kërkesë për leje prishje tuneli/bunkerit”; Shkresës nr. 3685/1, datë 20.4.2023, dalë nga Drejtoria Arsim, Kulturë, Rinisë, Sporteve dhe Komuniteteve Fetare, Sektori i Arsimit, dërguar Sektorit të Pronave Publike dhe Menaxhimit të Asteve, me lëndë: “Kërkesë për informacion, objekt fortifikues në Shkollën 9-vjeçare “Eftali Koçi””; Shkresës nr. 3685/2, datë 24.4.2023, dalë nga Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Asteve, dërguar Ndërmarrjes Rrugë, me lëndë: “Kërkesë për informacion në lidhje me vendstrehimin e ndodhur në Shkollën 9-vjeçare “Eftali Koçi””, shkresës nr. 181/1 prot., datë 27.4.2023, me lëndë: “Kthim përgjigje shkresës nr. 3685/2, datë 24.4.2023”, ardhur nga Ndërmarrja Rrugë, Shkresës nr. 3685/4, datë 05.5.2023, dalë nga Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Asteve, dërguar Drejtorisë Arsim, Kulturë, Rinisë, Sporteve dhe Komuniteteve Fetare, Sektorit të Arsimit, me lëndë: “Kthim përgjigje suajës nr. 3685/1 prot., datë 20.4.2023”; Shkresës nr.4841/3, dalë nga Drejtoria Arsim, Kulturë, Rinisë, Sporteve dhe Komuniteteve Fetare, Sektori i

Arsimit, dërguar Sektorit të Pronave Publike dhe Menaxhimit të Asteve, me lëndë: “Dërgohet shkresë e Ministrisë së Mbrojtjes për vazhdim të procedurave me objekt: “Rindërtimi i Shkollës 9-vjeçare dhe Kopsht “Eftali Koçi””; Shkresës nr. 4841, datë 19.5.2023, dalë nga Drejtoria Arsim, Kulturë, Rinisë, Sporteve dhe Komuniteteve Fetare, Sektori i Arsimit, drejtuar Ministrisë së Mbrojtjes, me lëndë: “Kërkesë mbi objektin fortifikues (vendstrehim) në shkollën 9-vjeçare + Kopsht “Eftali Koçi”, Shkresës nr. 4112 prot., datë 20.7.2023, ardhur nga Ministria e Mbrojtjes, drejtuar Bashkisë Durrës, me lëndë: “Kthim përgjigje shkresës me nr. 4841, datë 19.5.2023”, Leje Ndërtimi, e miratuar me Vendimin nr. 1256-22/4, datë 28.10.2022, për Rindërtimin e Shkollës 9-vjeçare + Kopsht “Eftali Koçi”, Vendim Leje Rindërtimi, Rikonstruksioni dhe Riparimi të ndërtesës së dëmtuar me shtim apo ndryshim Vëllimi, që mban nr. 1256-22/3 prot., datë 28.10.2022, sipas relacionit të përgatitur nga Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Asteve, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :



1. Miratimin për heqjen nga lista e pronave të pronës me nr. 374, sipas planvendosjes së ardhur nga Ndërmarrja Rruga, me emërtim “vendstrehim”, me vendodhje pranë shkollës 9-vjeçare “Eftali Koçi”, që me VKM nr. 536, datë 01.05.2008, ka kaluar në pronësi Bashkisë Durrës, për shkak se është e dëmtuar dhe është jashtë funksionit, kjo edhe sipas konkluzionit të Ministrisë së Mbrojtjes, përcjellë Bashkisë me shkresë nr. 4112 prot., datë 20.7.2023.
2. Toka (trualli), i liruar nga prishja e objektit fortifikues, sipas lejes së ndërtimit, e miratuar me Vendim nr. 1256-22/4, datë 28.10.2022, të përdoret për rindërtimin e godinës së Shkollës 9-vjeçare “Eftali Koçi”, e dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e 26 Nëntorit 2019.
3. Ngarkohen Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Asteve, Drejtoria Ekonomike dhe Ndërmarrja Rruga, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 06.11.2023



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT Durrës

Nr. 709 / Prot.

Durrës, më 13.11.2023

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS**

13 11 23 1022/7

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.171 datë 03.11.2023 “Për miratimin për heqjen nga kontabiliteti dhe lista përfundimtare të pronës me nr.374 të listës së transferimit, me emërtim “vendstrehim”, me vendodhje pranë shkollës 9-vjeçare “Eftali Koçi”, që me VKM nr.536 datë 01.05.2008 ka kaluar në pronësi të bashkisë Durrës”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI

